



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
SEKTOPI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

**PROJEKT- VENDIM**

Mbi përdorimin e fondit për projektin “**Qender ditore për fëmijë**” me financim të përbashkët nga Program i LNB ( LEAVE NO ONE BEHIDE) UNDP, dhe Bashkisë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, marrëveshjes së Bashkia Maliq me UNDP nr. 2107 prot., datë 12.04.2024., Kërkojmë nga **Këshilli i Bashkisë Maliq**:

**Të miratojë :**

1. Të miratojë përdorimin e fondit të deleguar nga program LNB , UNDP me vlerë **2,928,200** totale lekë (për një periudhë 1 vjecare ) për zbatimin e projektit “**Qender ditore për fëmijë**” të detajuar si më poshtë ;

1.1 Miratim fondi me vlerë totale projekti 2,928,200 Lekë të detajuar si më poshtë :

1.2 lekë për paga dhe sigurime të punonjësve që do të ofrojnë këtë shërbim sipas buxhetit të projektit;

Nr.	Pershkrimi i zërave te buxhetit	Njësia (orë/ ditë pune, në muaj, )	Sasia	Kosto për njësi në Lek	Kontributi i kërkuar nga LNB/total	Kesti 1	Kesti 2
<b>1</b>	<b>Burimet njerëzore</b>						
<b>1.1</b>	Paga punojës social/kordinator	muaj/8 ore pune	12 muaj	50,000	600,000	100,000	500,000
	<i>kontribute sig, shoqerore, shendetesore</i>	muaj/8 ore pune	12 muaj	8,350	100,200	16,700	83,500
	<i>3 Specialiste e kurseve (mesues)+ taksa (per 5 ore pune ne jave)</i>	ore/muaj	60 ore	1,200	864,000	216,000	648,000
<b>1.2</b>	<b>Shërbimet e konsulencës, prinderimi pozitiv</b>	takime	12 takime	7,000.00	84,000.00		84,000
	<b>Nën totali</b>				<b>1,648,200</b>	<b>332,700</b>	<b>1,315,500</b>

2.1 Miratim Fondi sigurimin e materialeve te nevojeshme per ofrimin e shërbimit si më poshtë:

Nr.	Pershkrimi i zërave te buxhetit	Njësia (orë/ ditë pune, në muaj, )	Sasia	Kosto për njësi në Lek	Kontributi i kërkuar nga LNB	Kesti 1	Kesti 2
2	Materiale per zhvillimin e aktiviteteve						
2.1	<b>Blerje pajisje</b>			<b>700000</b>	<b>700,000.00</b>	<b>350,000.00</b>	<b>350,000</b>
	Vegla Muzikore (kitare, violine, etj)	Vit	1	350000	350000	350000	0.00
	Kompjuter, printer, paisje audio, Tv, kondicioner	Vit	1	350000	350000		350,000
2.2	<b>Shpenzime operative</b>				<b>530000</b>	<b>530000</b>	<b>0.00</b>
	Artikuj sportive, materiale picture, didaktike kancelari etj	Vit	1		470000	470000	0.00
	Refreshments per takimet me prinder	takime	12		60000	60000	0.00
	promocion				50000		50,000
	<b>totali</b>				<b>1210000</b>	<b>880,000.00</b>	<b>400,000</b>

2. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për vërtëqeverisjen Vendore” i ndryshuar .

Pranoi: Përgj.Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

(Emër Mbiemër)  
E.Petriti

Nënshkrimi  


Data  
Dt 30.05.2024

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Gëzim Topçiu**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
SEKRETARE TË PËRGJITHËSHME

**Jonila Xhialli**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 30.05.2024

Relacion

Mbi përdorimin e fondit për projektin “**Qender ditore për fëmijë**” me financim të përbashkët nga Program i LNB ( LEAVE NO ONE BEHIDE) UNDP, dhe Bashkisë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, marrëveshjes së Bashkia Maliq me UNDP nr. 2107 prot., datë 12.04.2024, Bashkia Maliq do të iniciojë shërbimin e një qendrëe ditore per femijë.

Gjate zhvillimit te aktivitetit ne qender do te jepet mesim nga mesues te paguar me honorare sipas kerkesave te kursit, gjate orarit te mbasditeve, për instrumente muzikore, art pamor, sport .

Aktivitetet do të zhvillohen çdo ditë sipas një kalendari të caktuar, ku çdo orë mësimi për çdo program do të mbahet dy herë në javë në grupe me nga 10 fëmijë. Nëpërmjet zhvillimit të klasave, fëmijët do të rinovojnë njohuritë e tyre në fushën e muzikës, sportit dhe artit pamor. Duke rritur njohuritë e tyre, ata do të mund të shfaqin talentet e tyre dhe të konkurrojnë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë qendrës.

1. **Kostoja e projektit dhe shuma e kërkuar nga skema e granteve për shërbimet sociale me bazë komunitare**

Kostoja Totale e Projektit	Shuma e kërkuar nga UNDP-LNB	% e grantit të kërkuar
4,428,560 LEK Shqiptare	2,928,200 LEK Shqiptare	66.1 %

2. **Përmbledhja**

**Qëllimi**

Për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve të familjeve në nevojë dhe veçanërisht të komunitetit rom dhe egjiptian nëpërmjet integritit social, rritjes së aftësive jetësore dhe akademike për fëmijët, duke i bërë ata qytetarë të mirë dhe duke shmangur problemet sociale.

**Rezultatet e pritura**

1. 85 fëmijë të Bashkisë Maliq do të marrin shërbimin mbështetës pas shkollës me qëllim edukimin dhe zhvillimin e tyre në fushën intelektuale, sociale, shkencore, fizike dhe artistike. Mbështetja e 40 prindërve për të kuptuar dhe ndihmuar zhvillimin e fëmijës së tyre me Modulin e Prindërimit Pozitiv përmes këshillimit, mësimdhënies dhe dëgjimit të kujdesshëm.

**Aktiviteti kryesor**

• Aktiviteti 1\_Zhvillimi i mësimëve për instrumente muzikore dhe këndim, art pamor, sport etj  
Mësimet për instrumente muzikore, art pamor, sport do të zhvillohen çdo ditë sipas një kalendari të caktuar, ku çdo orë mësimi për çdo program do të mbahet dy herë në javë në grupe me nga 10 fëmijë. Nëpërmjet zhvillimit të klasave, fëmijët do të rinovojnë njohuritë e tyre në fushën e